



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:263532

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05524041

KF.nr.49/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “SFK” Sh.P.K., me numër fiskal 601261522 dhe seli në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson D.S. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të palës paditëse avokat D.S., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, me datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “SFK” Sh.P.K., me seli në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat D.S., si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.359/2019 i datës 25.09.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës, dhe lënda i kthehet në Rishyqrtim dhe Rivendosje të paditurës.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 30.10.2019, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.359/2019 të datës 25.09.2019. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e datës 14.03.2024 ka deklaruar se ka pranuar ekspertizën e ekspertit financiar R.F., duke theksuar dhe

kërkuar gjykatës ta administrojë si provë këtë ekspertizë meqenëse pala paditëse nuk e kundërshton këtë ekspertizë dhe në përgjithësi kjo ekspertizë ka konstatuar dhe konfirmuar pretendimet e palës paditëse në padinë e saj. Tutje ka theksuar se pas deklarimit të ekspertit paditësja kërkon zgjerimin e padisë ashtu që e paditura t'ia njoh paditësit "SFK" Sh.P.K., me seli në Prizren pikën-faktit 2 të Raportit të kontrollit nr. 131/2019 datë 04.07.2019 lidhur me njohjen e faturave të blerjeve – shpenzimeve për TVSH për vitet 2016, 2017 dhe 2018. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se bizneseve të dyshimta pra "Diana BE" Sh.P.K., "Alfa Gropu-1" dhe "Bais Textile" Sh.A., u është anuluar apo tërhequr çertifikata e TVSH-së në vitin 2018, ndërsa paditësi blerjet më të mëdha nga këto biznese i ka bërë apo realizuar në vitin 2016, 2017 dhe 2018, që do të thotë se në kohën e blerjeve dhe transaksioneve, këto biznese nuk e kishin të anuluar apo tërhequr certifikatën e TVSH-së, andaj inspektorët në raportin e kontrollës gabimisht kanë zbatuar nenin 23, paragrafi 6, pika 5 të UA nr.15/2010, rrjedhimisht është konfirmuar edhe me vendimin e të paditurës nr.359/2019 i datës 25.09.2019. Gjykatës i ka propozuar ta anuloj në tërësi si të pa bazuar vendimin e ATK-së me nr.359/2019 të datës 25.09.2019 dhe të detyrohet e paditura që t'ia njoh paditësit pikën-faktin 2 të raportit të kontrollit nr.131/2019 të datës 04.07.2019, lidhur me njohjen e faturave të blerjeve-shpenzimeve për TVSH, për vitin 2016,2017 dhe 2018. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura në përgjigje në padi të datës 15.01.2021 ka deklaruar se i kundërshton pretendimet e paraqitura në padi, si të pa bazuara në ligj dhe faktet materiale dhe vlerëson se vendimi i DA të ATK-së nr.359/2019 i datës 25.09.2019 është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Ka theksuar se vlerësimi i kontrollit për tatim shtesë është bërë në harmoni me nenin 19 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, sipas dokumentacionit të tatim paguesit të ofruar gjatë procedurës së kontrollit për periudhat kontrolluese. Tutje ka shtuar se pretendimet e paditësit se faturat e blerjes duhet pranuar për arsye se transaksionet me biznesin "Diana BE" Sh.P.K., dhe "Bais Textile" Sh.A., kanë ndodhur para se të njëjtëve t'i tërheqin çertifikatën e TVSH-së nga ATK dhe në lidhje me prezumimin e pafajësisë, ky pretendim nuk qëndron dhe vërtetohet si i pa bazuar, për faktin se kontrolli sipas Raportit të Kontrollit dhe deklarimeve të inspektorit të kontrollit gjatë seancës dëgjimore në DA, vlerësimin e mbështeti mbi bazën e informatave nga Drejtoria e Hetimeve Tatimore, sipas të cilave transaksionet me bizneset në fjalë nuk kanë ndodhur, pra janë transaksionet fiktive, veprimtaria e këtyre bizneseve nuk është në përputhje me faturat e lëshura, ATK-ja nuk i pranon blerjet nga këto biznese për qëllime tatimore. E paditura, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe ka

pranuar ftesën për këtë seancë nuk ka prezantuar, duke e njoftuar Gjykatën me parashtresën e datës 11.03.2024, se nuk do prezantoj në seancë dhe njëherit ka kërkuar nga Gjykata të veprohet në pajtim me nenin 38, par 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativë, po ashtu ka kundërshtuar në tërësi ekspertizën financiare të datës 23.02.2024 për faktin se nuk ka konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plot gjendjen faktike andaj Gjykata konform nenit 41 të LKA-së, e ka proceduar çështjen duke i lexuar parashtresat e të paditurës. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padia e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi nr. 359/2019 i datës 25.09.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 14.03.2024, ka administruar provat dhe atë: Përgjigja në padi e datës 15.01.2021, Vendimi kontestues nr.359/2019 datës 25.09.2019, Ankesë nr.359/2019 e datës 05.08.2019, Raporti i kontrollit nr.131/2019 datës 04.07.2019, Vendimi i ZGJONA nr.170/2019 datës 28.06.2019, Pasqyrë e tatim paguesit datës 25.06.2019, Kontratë e datës 01.04.2016, Krahasimi i shitjeve të deklaruar në libër të shitjes me pagesa të bëra në bankë nga institucionet shtetërore dhe private për vitin 2018 (provë e dorëzuar nga e paditura), Krahasimi i shitjeve të deklaruar në libër të shitjes me pagesa të bëra në bankë nga institucionet shtetërore dhe private për vitin 2017, Lista e shpenzimeve 01.01.2018-31.12.2018, Libri i blerjeve investive 01.01.2018-31.12.2018, Specifikacion i shpenzimeve të blerë nga biznesi "Diana BE" Sh.P.K-NF 6011608568, Libri i blerjeve investive 01.01.2017-31.12.2017, Specifikacion i shpenzimeve të blerë nga biznesi "Bais Textile" Sh.P.K-NF 601021926 për vitin 2016, Pasqyrë e tatim paguesit e datës 10.07.2019, Kartelë e furnitorit "Diana Be" Sh.P.K periudhë 01.01.2016-31.12.2016, Aktgjykim P.nr.566/2021 i datës 23.09.2021, Njoftim me shkrim tatim paguesit për caktimin e kontrollit, Kontakti me tatim paguesin datës 15.04.2019, Çertifikatë e regjistrimit të biznesit "SFK" Sh.P.K, Certifikate e regjistrimit të biznesit "Diana Be" SH.P.K, Certifikata- deklaratë e TVSH për "Diana Be" Sh.P.K, Gjendja nga ARBK për "Diana B" e printuar me datë 25.06.2019, Gjendja e përgjithshme nga Sigtasi, Faturat e dorëzuara nga e paditura, Kontratë për shitblerjen e paluajtshmërisë LPR.nr. 3970/2016 datës 18.10.2016, Kontratë e datës 24.11.2017 për shitblerjen e automobilit, Të dhënat nga thesari 29.05.2019, Libri i shitjes 01.01.2018-31.12.2018, Libri i shpenzimeve 01.01.2017-31.12.2017, Libri i shitjes për 01.01.2017-31.12.2017, Aktgjykim KF.nr.111/22 datës 05.12.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se ATK me datë 04.07.2019 ka kryer kontroll tatimor për subjektin “SFK” Sh.P.K., me seli në Prizren, këtu paditësin për TVSH: 01/2016-02/2019, TAK/CD: 2016/2017/2018, TMB/WM: 01/2017-12/2018, KP/CM: 01/2017-12/2018, qiraja WR: 06/2017-02/2019. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi ka ushtruar ankesë, në departamentin e ankesave në ATK, për të cilën ankesë ATK-ja ka nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë vendimin nr.359/2019 të datës 05.08.2019 me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa nr.359/2019, ndërsa njoftim rivlerësimit e tatimit shtesë janë vërtetuar si të bazuara, kundër të cilit vendimi paditësi ka ushtruar padi me datë 30.10.2019. Kontestuese në mes të palëve mbetet nëse blerjet e realizuara nga paditësi kanë të bëjnë me biznese fiktive dhe se cili ishte statusi i vërtetë i bizneseve të tilla gjatë realizimit të blerjeve.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.49/22 të datës 23.01.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar gjyqësor R.F., me detyrat përkatëse.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 23.02.2023, sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 14.03.2024, nga ana e ekspertit financiar R.F., për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi dhe konstatimi se: *Trajtimi-mospranimi i faturave të blerjeve nga ana e inspektorëve të ATK-së, me procedurë kontrolli nga subjektet “Diana BE” Sh.P.K., me NF 601608568 “Alfa Group-1” Sh.P.K., me NF 601671673 si dhe “Basi Textile” Sh.a me NF 601021926 me arsyetim se këto biznese janë të dyshuara për transaksione fiktive nuk ka MBËSHTETJE LIGJORE, pasi që në periudhën e kryerjes së këtyre transaksioneve këtyre bizneseve nuk u është tërhequr certifikata e*

TVSH-së dhe se këto të dhëna të cilat eksperti i ka nxjerrë nga faqja zyrtare e ATK-së i demantojnë konstatimet e kontrollit të ATK-së me vetë faktin se në kohën e kryerjes së transaksioneve këtyre subjekteve nuk u është tërhequr çertifikata e TVSH-së. Lidhur me këtë eksperti ka cituar edhe Udhëzimin Administrativ nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedura. Po ashtu eksperti ka cituar edhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP-nr.39/2015 i datës 27.04.2016 në faqen 4 citon: “ Kjo Gjykatë i konsideron të papranueshme arsyet e paraqitura nga Administrata Tatimore, të cilat pranohen edhe nga gjykata e instancave më të ulëta, sepse blerësi nuk mund të jetë përgjegjës pse shitësit i mungon mirëbesimi dhe nuk i deklaruar obligimet e veta tatimore, sidomos kur kohet parasysht fakti që Administrata Tatimore nuk kishte publikuar njoftimet se gjoba bëhet fjalë për një afaristë pa mirëbesim, në mënyrë që blerësit të viheshin në dijeni me kohë për këtë gjë”.

Eksperti financiar në seancë e shqyrtimit gjyqësor-kryesor të datës 14.03.2024 ka theksuar se në tërësi qëndron pran ekspertizës financiare të dorëzuar në gjykatë me datë 23.02.2024, ku cek se ka listuar të gjitha shkresat e lëndës, ka bërë një vizitë pune paditësit në Prizren me datë 13.02.2024, ka shfletuar edhe faqen zyrtare të ATK-së, gjegjësisht publikimet e ATK-së të cilat i bënë për bizneset ku ju anulohet certifikata e TVSH-së dhe të gjitha këto prova i ka analizuar dhe përpunuar në hollësi dhe bazuar në detyrat e caktuara nga gjykata ka hartuar këtë ekspertizë financiare.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në fakt në vendimin e kontestuar por edhe në raportin e kontrollit nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike sikurse edhe nga faktet e vërtetuara është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues nr.359/2019 të datës 25.09.2019 Gjykata konstaton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, nuk ka vërtetuar me çfarëdo fakti ose prove në mes të bizneseve të dyshimta (fiktive) dhe tatim paguesit ishin prodhuar fatura fiktive apo jo ekzistencë, por vetëm ka cekur se paditësi për vitet 2016, 2017 dhe 2018 ka bërë blerje nga biznese të dyshimta, konstatim të cilin e ka dhënë duke u bazuar në nenin 23 paragrafi 6, pika 5 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 ku thuhet: “tatimpaguesit të cilëve u është anuluar apo tërhequr çertifikata e TVSH-së (lidhet vetëm me kreditimin e TVSH-së).

Udhëzimi administrativ 15/2020, me nenin 16, e ka rregulluar mënyrën e veprimit të ATK-së për zbatimin e nenit 23 të Ligjit nr.03/L-222, me të cilin përcakton se *“1. Në përputhje me Nenin 23 të Ligjit, ATK është e autorizuar të publikojë emrat, numrat fiskal dhe Numrat e Regjistrimit në TVSh, të të gjithë tatimpaguesve që plotësojnë dispozitat e aplikueshme të Neneve 9 , 12 , 13 , 14 dhe 15 të këtij Udhëzimi Administrativ. 2. ATK do të bëjë publikimin e emrave, numrave fiskal dhe Numrave të Regjistrimit në TVSh të atyre bizneseve në listën në paragrafin 1 të këtij Neni brenda 5 ditëve të punës pasi të jetë marrë vendimi për të ndërmarrë veprimet e specifikuar në Nenin 23 të Ligjit. ATK do të publikojë informatat në ueb faqen e internetit dhe do të lëshoj një njoftim në gazeta ditore në lidhje me listën e publikuar.”*

Sipas shkresave të lëndës, rezulton se e paditura ka vepruar konform dispozitës së lartcekur, mirëpo raportin e ka bazuar në rezultatin i cili është krijuar pas anulimit të certifikatave të bizneseve të caktuara.

Në procedurën e kontestit tregtar administrativ gjyqësor, Gjykata duke qenë se bazuar në dispozitën nga neni 44, par 1, i LKA-së, ku është përcaktuar qartë se *“1. Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. 2. Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare “ dhe pasi që gjykata ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimit të të paditurës, pasi që ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura duke mos i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete, ka vendosur se vendimi i kontestuar duhet të rishqyrtohet nga e paditura.*

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-së. Duke pasur parasysh konstatimet e lartcekura, gjykata konkludon se në këtë kontest tregtar administrativ ekzistojnë të meta të cilat pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë për arsye se në vendimin kontestues nuk janë dhënë arsye të bazuara se mbi cilën bazë është vërtetuar se paditësi ka bërë blerje nga biznese të dyshimta.

Nga kjo gjendje faktike gjykata konstaton se e paditura me anë të vendimit kontestues nuk ka mundur të shpjegoj qartazi se veprimtaria e këtyre bizneseve a është në përputhje me faturat e lëshuara dhe se a janë bërë blerje nga këto biznese të dyshimta (fiktive), a kanë qëndruar këto në listën e bizneseve të dyshimta. Gjykata i vlerësoj të drejta pretendimet e paditësit se bizneseve të dyshimta “Diana BE” Sh.P.K., “Alfa Group-1” Sh.P.K., si dhe “Basi Textile” Sh.a., u është anuluar apo tërhequr certifikata e TVSH-së në vitin 2018, ndërsa paditësi blerjet më të mëdha nga këto biznese i ka realizuar në vitin 2016, 2017 dhe 2018 që do të thotë se në kohën e blerjeve dhe transaksioneve, këto biznese nuk e kishin të anuluar apo tërhequr certifikatën e TVSH-së. Rrjedhimisht, Gjykata kërkon nga e paditura të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike, të deklarohet lidhur me çështjet e ngritura si më lartë dhe të marr për bazë edhe të gjeturat nga ekspertiza financiare.

Andaj, e paditura detyrohet që në rishqyrtim dhe rivendosje të vërtetoj edhe njëherë faktin se blerjet janë realizuar në vitet 2016, 2017 dhe 2018 , periudha kur këto biznese kanë qenë aktive.

Të metat e cekura më lartë pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe, në këtë drejtim gjykata konform nenit 43 par.2 të LKA-së e obligon të paditurën që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, dhe pasi t’i mënjanoj këto të meta të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 se: “*Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit*”.

Vërejtjet e gjykatës janë te obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi gjykata e mori konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave të nenit 81.C, 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 43 parag, 2 të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.49/22, datë 14.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.